



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 22.4.2021

Lënda: Qëndrim mbi parashtrimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, në seancat gjyqësore të datës 18 mars 2021 dhe 13 prill 2021

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

1. Në seancën gjyqësore të datës 13.4.2021, trupi gjykues vendosi t’i kërkojë Komisionerit Publik të shprehet lidhur me provat e administruara nga Kolegji në seancat gjyqësore publike të datës 18 mars 2021 dhe 13 prill 2021, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, z. Madani. Këto akte na u vendosen në dispozicion zyrtarisht nga Kolegji në datën 14 prill 2021, sipas formës së kërkuar nga Kodi i Procedurës Civile.

2. Komisioneri Publik, në zbatim të detyrës së lënë nga trupi gjykues, shqyrtoi parashtrimet e subjektit, z. Madani, të datës 18 mars 2021, dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të cilat u lejuan për t’u marrë nga Kolegji në cilësinë e provës, shqyrtim i bërë në raport me secilin shkak të ankimit të datës 22.10.2019, kundër vendimit nr.173, datë 1.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si *Ankimi*).

3. Për shkakun ankimor, për pasurinë “apartment banimi 146 m²” dhe pasurinë “garazh 10m²”, në rrugën “***”, Durrës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

– Shkresë nr. ***/*** prot., datë ***.7.2020, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë. Dokumentacioni shkresor shoqërues është fotokopje e dokumentacionit tekniko-ligjor, i regjistrimit të pasurisë pallat nr. ***/***, zona kadastrale ***, si dhe fotokopje të kontratave të shitjes lidhur ndërmjet shoqërisë “***” sh.p.k. dhe blerësit, sipas referencave për 25 kontrata.

– Pamje të një ambienti garazh, në formatin fotokopje.

– Shkresë nr. ***/***/prot., datë ***.7.2020, e OSHEE Group, Drejtoria Rajonale Durrës, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë. Dokumentacioni shkresor përmban 31 fletë të printuara nga Sistemi i Menaxhimit të Kontratave, ku rezultojnë 31 kontrata furnizimi me energji elektrike në objektin e banimit, pallati “***”, për periudhën 2001 deri në vitin 2004.

– Deklaratë noteriale nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.1.1998, të zotit *** ***, me anë të cilës, ndër të tjera, z. ***, ***, deklaron se: “...në këtë shtëpi kam strehuar djalin tim, Artan Madani, me gjithë familjen e tij...”.

– Vërtetim përkthimi, i datës ***.2.2021, nga gjuha greqisht në gjuhën shqipe, për dokumentin “Listë pagese”. Dokumenti shoqërues është karta e identitetit të siguracionit dhe kontributeve për *** ***, për periudhën ***.5.1998 - ***.12.1998, lëshuar nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Greqisë.

– Redaktim procesverbal për bërje inventari (*redaktim procesverbal konstatimi*), akt noterial me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë ***/4/2021, për korrespondencë elektronike të datës ***.4.2021, për materiale në gjuhë të huaj.

3.1 Në referencë të përmbajtjes së këtyre akteve dhe nivelit të provueshmërisë në raport me shkaqet e ankimit, Komisioneri Publik parashtron sa vijon:

3.1.1 Për “*gjendjen juridike të pasurisë ‘apartament me sipërfaqe 146 m²’, në momentin e krijimit*”, aktet e paraqitura nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe nga OSHEE, drejtoritë vendore Durrës, nuk provojnë/dëshmojnë ndonjë situatë të ndryshme nga ato të cilat kanë çuar në përfundimin në *Ankim*¹. Nënvizojmë se në ankimin e Komisionerit Publik nuk pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka filluar të banojë në “apartament banimi 146 m²” që në vitin 2000, por se gjendja juridike/ligjore e kësaj pasurie, në vitin 2000, nuk rezulton si “karabina”. Aktet e zyrtare të administruara, si: vendim gjykate, procesverbal kolaudimi, leje shfrytëzimi (banimi), që kanë shërbyer për regjistrimin e pallatit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, dëshmojnë përfundimin e këtij ndërtimi, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës, në vitin 2000.

3.1.2 Për burimin e krijimit “*kursime ndër vite dhe pjesëtim vullnetar nga shitja e banesës së prindërve*”, akti i paraqitur në seancë: *Deklaratë noteriale e datës ***.1.1998, e z. ***. ****², nuk dëshmon ndonjë situatë të ndryshme nga ato të cilat kanë çuar në përfundimin në *Ankim*³. Nënvizojmë se në ankim nuk është pretenduar se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin e deklarimit “*të dhuratave*”, sipas parashikimit të nenit 5, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave ...*”, por se në deklaratën përkatëse, në plotësimin e rubrikës: “*Burimi (konkret dhe jo i përgjithshëm)*”, subjekti i rivlerësimit, në pozitën e subjektit

¹ Referojuni ankimit të Komisionerit Publik, pika 21.10 “...subjekti ka blerë pasurinë ‘Apartament banimi 146 m²’, të përfunduar plotësisht që në vitin 2000, pra është i pabazuar pretendimi se pasuria ‘Apartament banimi 146m²’ ishte në fazë karabinaje, dhe rëndon pozitën e subjektit duke qenë në kushtet e deklarimit të rremë, për sa kohë pasqyrohet çmim artificialisht më i ulët në kontratën e shitjes. Subjekti i rivlerësimit pretendon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratave noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme dhe akteve të tjera zyrtare, të cilat, në kuptim të nenit 253, të Kodit të Procedurës Civile, përbëjnë provë të plotë”.

² Ndër të tjera, z. ***, ***, deklaron se: “...në këtë shtëpi kam strehuar djalin tim, Artan Madani, me gjithë familjen e tij...”.

³ Referojuni ankimit të Komisionerit Publik, pika 21.15.5 “...rezulton e provuar se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë, pasi pretendimi i tij dhe konkluzioni i Komisionit, se kishte mungesë baze ligjore për deklarimin e kontributeve si dhurata, nuk qëndron, për sa kohë që në formularin e Deklarimit të parë është specifikuar qartësisht detyrimi për të deklaruar burimin e krijimit të pasurisë. Për sa kohë ky dhurim ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, subjekti kishte detyrimin ligjor ta specifikonte që në Deklaratën e parë. Nuk provohet me dokumentacion ligjor justifikues mundësia financiare e dhurimit nga z. ***. ***”.

deklarues, kishte detyrimin ta specifikonte çdo burim, që ka shërbyer për krijimin e pasurisë, në formën përkatëse që konkretizohej ai.

3.1.3 Për burimin e krijimit: *“dhuratat e marra nga z. ***. *** dhe ***. ***”, akti i paraqitur në seancë: Karta e identitetit të siguracionit dhe kontributeve për ***. ***, për periudhën ***.5.1998 - ***.12.1998, nuk dëshmon ndonjë situatë të ndryshme nga ato të cilat kanë çuar në përfundimin në Ankim⁴.*

4. Për shkakun e ankimit, *“mungesa e të ardhurave të ligjshme nga burime të ligjshme, për investimin në fondin e investimeve ‘***’, në shumën 5.500.000 lekë, në *** Bank, gjendjes cash në banesë, të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë dhe rezultatet e analizës dhe treguesve financiarë ndër vite”, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin si vijon:*

- Deklaratë noteriale nr. *** rep. dhe *** kol., datë ***.8.2020, me deklarues shtetasi *** ***;
- Vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë ***.2.2021, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, për dokumentin “akt noterial”;
- Vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë ***.4.2021, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, për dokumentin “Shitblerje”;
- Vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë ***.4.2021, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, për dokumentin “Certifikatë kontenstuale e rezidencës, gjendjes familjare dhe gjendjes civile”;
- Vërtetim përkthimi nr.*** rep., datë ***.4.2021, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, për dokumentin “Certifikata historike e rezidencës Savona”;
- Vërtetim përkthimi me nr. *** rep., datë ***.1.2021, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, shoqëruar me deklaratë, që mban datën ***.7.2020, të znj. *** *** ***;
- Deklaratë noteriale nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.7.2020, me deklarues z. *** ***;
- Vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë ***.2.2021, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, për dokumentin “Kontratë shitblerje”;
- Deklaratë noteriale nr. *** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.12.2020, me deklarues z. *** ***;
- Vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë ***.2.2021, nga gjuha greke në gjuhën shqipe, për dokumentin “Kontratë qiraje”;
- Vërtetim përkthimi nr. *** rep., datë ***.9.2020, gjuha greke në gjuhën shqipe, për dokumentin “Deklaratë Personale”;
- 3 fletë në formë tabelare me përshkrimin: “Analizë financiare për periudhën 1992 - 1996”, “Analizë financiare për periudhën 1992 - 2003”, “Analizë financiare për vitin 2011” – me timbrin Ekspert Kontabël Autorizues ***.***, Tiranë, Albania, e firmosur;
- Shkresë nr.*** prot., datë ***.2.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë, me lëndë: “Vërtetim mbi të ardhurat e përfituara nga paga, dieta, bonusi i karburantit dhe shpërblimet e z. Artan Madani, për periudhën prill 2008 – prill 2012”, fotokopje;

⁴ Referohuni ankimit të Komisionit Publik, pika 21.15.7: *“...subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për sa kohë nuk i ka deklaruar këto të ardhura si burime të krijimit të pasurisë në Deklaratën e parë, DV-2004 dhe D-Vett. Nuk provohet me dokumentacion ligjor justifikues mundësia financiare e dhurimit nga z. ***. ***. dhe z. ***. ***., ndaj dhe nuk konsiderohen si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.*

- 4 fletë, format A4 , në formë tabelare, të titulluar: “Artan Madani, Analizë financiare për periudhën 2003 - 2016”.

4.1. Në referencë të përmbajtjes së këtyre akteve dhe nivelit të provueshmërisë në raport me shkaqet e ankimit, Komisioneri Publik parashtron sa vijon:

4.1.1. Për zërin: “*Shpenzime të udhëtimit për jashtë shtetit*”, aktet e administruara rishtazi nuk dëshmojnë ndonjë situatë të ndryshme, për arsytet në vijim:

4.1.1.1. Për shpenzimet e udhëtimit në qytetin Savona, Itali, periudha ***.7.2011 – ***.8.2011, aktet e paraqitura të z. *** *** nuk ndikojnë në përfundimet e arritura në *Ankim*, pasi shpenzimi i këtij udhëtimi nuk ndryshon nga shpenzimi i deklaruar nga subjekti, z. Madani, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision⁵.

4.1.1.2. Për shpenzimet e udhëtimit në qytetin Rimini, Itali, periudha ***.8.2012 deri në ***.8.2012, aktet e paraqitura të znj. *** *** nuk ndikojnë në përfundimet e arritura në *Ankim*, pasi shpenzimi i këtij udhëtimi nuk ndryshon nga shpenzimi i deklaruar nga subjekti, z. Madani, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision⁶.

4.1.1.3. Për shpenzimet e udhëtimit në qytetin Rimini, Itali, periudha ***.7.2014 – ***.7.2014, aktet e paraqitura të z. *** *** nuk ndikojnë në përfundimet e arritura në *Ankim*, pasi shpenzimi i këtij udhëtimi nuk ndryshon nga shpenzimi i deklaruar nga subjekti, z. Madani, gjatë procesit të rivlerësimit në Komision⁷.

4.1.1.4. Për shpenzimet e udhëtimit në qytetin Athinë, Greqi, periudha ***.8.2015 – ***.8.2015, aktet e paraqitura të z. *** *** dhe znj. *** *** , nuk ndikojnë në përfundimet e arritura nga Komisioneri Publik⁸, pasi nuk provohet ndonjë rrethanë e ndryshme dhe vlerat e deklaruara nga subjekti në lidhje me këtë shpenzim udhëtimi janë kontradiktore, për sa vijon:

- Në DV-2015, subjekti ka deklaruar shpenzime për pushime vjetore, në muajin gusht 2015, nga vajtja në Greqi familjarisht, për një periudhë 7-ditëshe, shuma 2.500 euro. “*Kam lëvizur te kunati e të tjerë, por edhe shpenzime rruge, hotel etj.*”

- Në përgjigjet e datës 21.5.2018, subjekti ka deklaruar shpenzime pushimi 2.500 euro.

- Në dokumentin: “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ...”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “*Në lidhje me udhëtimin e ***.8.2018 – ***.8.2015, në Athinë – Greqi, shpenzimet janë në vlerën 1.500 euro dhe jo 3.300 euro. Kjo pasi kemi qenë të akomoduar te kunati im, vëllai bashkëshortes, *** ***.*”

⁵ Referohuni faqes nr. 11 të dokumentit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani”, ku, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “*Në udhëtimin e datës ***.7.2011 – ***.8.2011, në Savona -Itali, shpenzimet janë 1.800 euro dhe jo 2.625⁵ euro. Kujtoj se në këtë rast kam ndenjur te njerëzit e mi, të cilat i kam shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 1, duke dhënë emrat dhe adresat përkatëse.*”

⁶ Referohuni faqes nr.11 të dokumentit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani”, ku, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “*Në lidhje me udhëtimin e datës ***.8.2012 – ***.8.2011, në Rimini – Itali, për pushime, shpenzimet janë në vlerën 2.000 euro dhe jo 3.125 euro, pasi, siç kam shpjeguar në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, kam qenë te vajza e hallës së bashkëshortes...*”.

⁷ Referohuni faqes nr.11 të dokumentit “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani”, ku, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “*Në lidhje me udhëtimin e datës ***.7.2014 – ***.7.2014, në Rimini – Itali, për pushime, shpenzimet kanë qenë në vlerën 2.000 euro dhe jo 3.875 euro. Kjo pasi në këtë rast kam qenë i akomoduar në banesën e mikut të familjes, *** ***...*”.

⁸ Në pikën 22.11.(iii) të ankimit parashtrorjme: “*Shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit, që vijnë në kundërshtim me vetë deklarimet e subjektit, përdorur në funksion të nevojave të tij për të mbuluar diferencat negative ndër vite, duheshin llogaritur bazuar në të dhënat e sistemit TIMS dhe në zbatim të metodologjisë orientuese të Kolegjit, vendimi (JR) nr.11/2019*”.

4.1.2. Për zërin “*Të ardhura nga paga*”,⁹ referuar parashtrimeve të subjektit të datës 18.3.2021 dhe shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Lezhë¹⁰, ku në të ardhurat e përfituara pranë këtij institucioni, përfshihen të ardhurat nga pagat, shpërblimet, bonusi i karburantit¹¹ dhe dietat, referuar jurisprudencës së Kolegjit dhe argumentimit përkatës mbi të ardhurat nga bonusi i karburantit¹² dhe dietat,¹³ vlerësohet se të ardhurat nga bonusi i karburantit dhe dietat nuk mund të përfshihen në zërin e të ardhurave me burim marrëdhënien e punës.

4.1.3. Për dokumentin e emërtuar: “*Analizë financiare për periudhën 1992 – 1996*”, “*Analizë financiare për periudhën 1992-2003*”, vërejmë se: (i) zëri “shpenzime jetese para vitit 2003”, duket se është marrë në masën rreth 35% të të ardhurave, çka nuk bazohet në vendimmarrjet e Kolegjit¹⁴, ku përllogaritja e shpenzimeve të jetesës për këto periudha është në masën 66% të të ardhurave familjare, (ii) në zërin e të ardhurave janë përfshirë “*dhurimet në cash*” nga babai, bashkëshortja, vjehri, kunati, për të cilat nuk rezultojnë dokumentacion i justifikues ligjor.

4.1.4. Për dokumentin e emërtuar: “*Analizë financiare për vitin 2011*”, vërejmë se: (i) në zërin **Të ardhura nga paga**, janë përfshirë edhe të ardhurat nga bonusi i karburantit dhe dietat, për të cilat u shprehëm sa më lart; (ii) zëri i **likuiditeteve cash**¹⁵ nuk gjen pasqyrim në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DV-2011.

4.1.5. Për dokumentin e emërtuar “*Artan Madani, Analizë financiare për periudhën 2003-2016*” vërejmë sa vijon:

(i) Në zërin **Të ardhura**, ndër të tjera, për “*pagat nga funksioni*”, në vitin 2010 dhe 2011, janë përfshirë bonusi i karburantit dhe dietat, zë që ka gjetur trajtim më lart në këtë parashtrësë. Gjithashtu, përveç dhurimeve *cash* deri në vitin 2003, janë përfshirë “*dhurime në cash*” për vitet 2007 dhe 2015, për të cilat nuk rezultojnë dokumentacion i justifikues ligjor. Për vitin 2005 është përfshirë shuma 300.000 lekë, si e ardhur “*nga shitja e pasurive të luajtshme*”, për të cilën nuk rezultojnë dokumentacion i justifikues ligjor.

(ii) Në zërin **Asete**, ndër të tjera, janë përfshirë vlerat në “*likuiditete*” për periudhën 2004-2016, të cilat nuk janë të njëjta me vlerat e deklaruara dhe ato të dokumentuara nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit për periudhën 2004-2016¹⁶.

(iii) Në zërin **Shpenzime**, ndër të tjera, janë përfshirë: “*shpenzime INSTAT + raporti ILDKPKI*”, për periudhën 2004-2016, këto shpenzime nuk janë në përputhje me të dhënat zyrtare të INSTAT /ILDKPKI për këtë periudhë.

(iv) Në zërin **Shpenzime**, ndër të tjera, janë përfshirë: “*shpenzime bileta, udhëtime*” dhe “*shpenzime pushimi*”, të padokumentuara, të cilat duket se nuk janë në përputhje me të dhënat e sistemit TIMS dhe në zbatim të metodologjisë orientuese të Kolegjit në vendimin (JR) nr.11/2019.

⁹ Në pikën 22.11.(v) të ankimit parashtrojmë se: “*Vlerat e përfituara nga bonusi i karburantit dhe dietat nuk duheshin përllogaritur në zërin ‘të ardhura’, pasi nuk është në përputhje me metodologjinë orientuese të Kolegjit (JR 7/2019)*”.

¹⁰ Mbi të ardhurat e përfituara nga paga, dieta, bonusi i karburantit dhe shpërblimet e z. Madani, për periudhën prill 2008 – prill 2012.

¹¹ Në vitin 2010, shuma 280.000 lekë; në vitin 2011, shuma 350.000 lekë; në vitin 2012, shuma 205.000 lekë.

¹² Shihni vendimin e Kolegjit, që lidhet me subjektin e rivlerësimit, ***, ***, [JR nr. 24/2020], paragrafi 11.6.2.

¹³ Shihni vendimin e Kolegjit, që lidhet me subjektin e rivlerësimit ***, ***, [JR nr. 7/2019], paragrafët 34, 36, vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit ***, ***, [JR nr. 01/2020], paragrafi 15 dhe vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit ***, ***, [JR nr. 04/2020], paragrafi 61, vendimin që lidhet me subjektin e rivlerësimit ***, ***, [JR nr. 1/2021], paragrafi 27.7. “c”.

¹⁴ Shihni vendimin e Kolegjit që lidhet me subjektin e rivlerësimit ***, ***, [JR nr. 18/2019], paragrafi 21.4.

¹⁵ Referuar “*Analizës financiare për vitin 2011*”, zërat: “*Ndryshim gjendje monetare CASH, fillim periudhe & Ndryshim gjendje monetare CASH, fund periudhe*”.

¹⁶ Referuar vlerave të deklaruara në Deklaratat periodike vjetore dhe pasqyrave të lëvizjeve në llogaritë bankare, për gjendjen e llogarisë në fund të çdo viti.

Në të tilla rrethana, në gjendjen që janë aktet, analiza financiare e sjellë nga subjekti për periudhën 2003-2016 nuk dëshmon ndonjë situatë të ndryshme nga ato të cilat kanë çuar në përfundimin në *Ankim*.

5. Për shkakun ankimor *për automjetin me targë AA*** ***, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- Deklaratë noteriale me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., e datës ***.1.2017, deklarues z. *** **;
- Fletë printimi nga sistemi TIMS, Raport i personit Artan Madani;
- Fletë printimi nga sistemi TIMS, Raport i personit *** **;
- Vërtetim njësia me origjinalin me nr. **, datë ***.4.2021, “Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, me palë të siguruar ***, me palë të siguruar *** dhe *** **, për mjetin FORD, me targa AA*** **, me periudhë sigurimi ***/11/2020 - ***/11/2021”.

5.1. Në referencë të përmbajtjes së këtyre akteve dhe nivelit të provueshmërisë në raport me shkaqet e ankimit, Komisioneri Publik vlerëson se aktet e paraqitura, situatën e provueshmërisë e lënë të njëjtë me atë të kohës së paraqitjes së ankimit.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA